



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 01. shkurt 2012
Nr. ref: RK.197/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 43/09

Parashtruesi

Lëvizja FOL

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Protokollit për Bashkëpunim Policor në mes të Misionit Evropian për Drejtësi dhe Sundim të Ligjit dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Serbisë, të datës 11 shtator 2009

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Lëvizja Fol, një OJQ e pavarur me seli në Prishtinë të cilën e përfaqëson Ramadan Ilazi (drejtor ekzekutiv).

Akti i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Protokollit për Bashkëpunim Policor të nënshkruar midis Misionit Evropian për Drejtësi dhe Sundim të Ligjit (në tekstin e mëtejme: EULEX) dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Serbisë, më 11 shtator 2009.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese të bëjë interpretimin e nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili parashikon se “Kuvendi është institucioni ligjvënës i Republikës së Kosovës...”, kundrejt nënshkrimit të njëanshëm të Protokollit të lartpërmendur nga ana e EULEX-it.
4. Parashtruesi i kërkesës konsideron se nënshkrimi i njëanshëm i protokollit të lartpërmendur nga EULEX-i paraqet shkelje të neneve 18.1, 65.12 dhe nenit 93.1 të Kushtetutës.

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës; neni 20 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 36 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Procedura në Gjykatë

6. Më 25 shtator 2009, parashtruesi i kërkesës e parashtrroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.
7. Më 2 tetor 2009, Gjykata i dërgoi parashtruesit të kërkesës një njoftim dhe i sugjeroi që të dorëzonte formularin e kërkesës.
8. Rrjedhimisht, sekretariati e regjistroi kërkesën e parashtruesit me nr. KI 43/09.
9. Më 31 maj 2010, parashtruesi i kërkesës e dërgoi përgjigjen e tij në shkresën e datës 2 tetor 2009 në të cilën theksonte se kërkesa e tyre nuk do të thoshte se “Lëvizja FOL do të jetë palë dhe se do të plotësonte procedurat administrative në mënyrë që kërkesa të shqyrtohej si një rast i rregullt”. Në të njëjtën kohë, parashtruesi i kërkesës e ritheksoi interesimin e tij që Gjykata Kushtetuese të japë mendimin e saj në lidhje me nënshkrimin e protokollit të lartpërmendur.
10. Kryetari i Gjykatës e emëroi gjyqtarin Čukalović Gjyqtar raportues si dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), dhe gjyqtarët Kadri Kryeziu dhe Iliriana Islami.
11. Më 16 maj 2011, pasi e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 11 shtator 2009, u nënshkrua Protokollin për Bashkëpunim Policor në mes të EULEX-it dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

13. Parashtruesi i kërkesës vlerëson se Protokoli për Bashkëpunim Policor është në kundërshtim me nenet 18.1, 63, 65.12 dhe 93.1 të Kushtetutës.
14. Në kërkesën e tij, parashtruesi i ka ngritur disa shqetësime në lidhje me respektimin dhe ushtrimin e sovranitetit nga ana e institucioneve të Republikës së Kosovës dhe konsideron se një interpretim nga ana e Gjykatës Kushtetuese do të ishte i nevojshëm në lidhje me Protokollin për Bashkëpunim Policor.
15. Parashtruesi bën me dije se implementimi i Protokollit për Bashkëpunim Policor është i pamundur pa përfshirjen e institucioneve të Kosovës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

16. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
17. Në kërkesën e tij parashtruesi i kërkesës i referohet nenit 113.7 dhe nenit 32 të Kushtetutës.
Neni 113.7 i Kushtetutës parashikon si në vijim:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

18. Për më tepër, neni 32 i Kushtetutës thotë:

“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.”

19. Në bazë të parashtrësive të parashtruesit të kërkesës duket se, përderisa nuk e konsiderojnë vetveten palë në procedurat para Gjykatës Kushtetuese, ata me kohë kanë theksuar interesimin e tyre që Gjykata Kushtetuese të japë mendimin e saj në lidhje me nënshkrimin e protokollit të lartpërmendur.
20. Në këtë drejtim, duhet të silllet ndër mend neni 48 i Ligjit, i cili përcakton:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë.”

21. Për qëllimet e Kushtetutës, viktimë konsiderohet personi fizik ose juridik (shih rastin Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K, Prishtinë, kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, rasti Nr. KI. 41 /09) të drejtat kushtetuese të të cilit janë prekur personalisht apo drejtpërdrejtë nga një masë apo akt i autoriteteve publike.
22. Një person i cili nuk preket në këtë mënyrë nuk e ka statusin e viktimës pasi që Kushtetuta nuk parasheh *actio popularis*. Me fjalë të tjera, një parashtrues kërkesë nuk mund të ankohet në mënyrë abstrakte për masat e autoriteteve publike që nuk janë zbatuar personalisht ndaj tij, siç është ky rast para kësaj Gjykate.

23. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me Kushtetutë i janë shkelur apo janë duke u shkelur aktualisht drejtpërdrejt nga një autoritet publik (shih Vanek kundër Republikës Sllovaqe, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, të datës 31 maj 2005).
24. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës nuk është palë e autorizuar dhe kërkesa duhet hedhur poshtë si e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 36 të Rregullores së Punës,

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme.
- II. Vendimi do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Prof. Dr. Ivan Čukalović



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani

